

VENDIM
Nr. 497, datë 16.7.2019

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 289, DATË 10.5.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË FINANCave DHE EKONOMISË TË PASURISË ME NUMËR
33/76, ZONA KADASTRALE 8523, ME SIPËRFAQE TRUALL 7726 m² DHE
SIPËRFAQE NDËRTESË 7307 m², ME VENDNDODHJE NË ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1, të vendimit nr.289, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Autorizohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë të vendosë në dispozicion të shoqërisë “Ital-Druri”, sh.p.k., Elbasan, pasuritë me numër 33/76, zona kadastrale 8523, me sipërfaqe truall 7 726 (shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) m² dhe sipërfaqe ndërtësë 7 307 (shtatë mijë e treqind e shtatë) m², pronë shtet, me vlerë 188 386 858 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, për rritjen e kuotës së kapitalit shtetëror.”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama